



KOMUNA E GJAKOVËS

OPŠTINA DJAKOVICA / MUNICIPALITY OF GJAKOVA

Republika e Kosovës - Republika Kosovo  
Komuna e Gjakovës - Opština Djakovica  
Drejtorija për Punë të Përgjithshme Administrative  
Uprava za Opšte, Administrativne Poslove

01  
Nr./Br. 011/01-9336  
Data/Datum 20.12.2019

Gjakovë, Djeqori i Gjakovës

Kuvendi i Komunës së Gjakovës  
01 Nr. /2019  
Datë: 18.12.2019

Kuvendi i Komunës së Gjakovës, në bazë të nenit 12 Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, dhe në nenin 18 të Statutit të Komunës së Gjakovës, nenin 53 të Ligjit nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, në mbledhjen e mbajtur me datë 18.12.2019 pas diskutimit lidhur me pikën e 3 të rendit të ditës: Propozim-Vendim për shfuqizimin e vendimit 01nr.011/01-9336 të datës 06.03.2019, për Këmbimin e Pronës Komunale, e miratoi këtë:

V E N D I M

Për

Shfuqizimin e Vendimit të Kuvendit të Komunës 01nr.011/01-9336 të datës 06.03.2019

1. Shfuqizohet Vendimi i Kuvendit të Komunës së Gjakovës 01nr.011/01-9336 i datës 06.03.2019 për këmbimin e pronës Komunale ndërmjet N.P H.A.B- INXHINIERING, si bashkëpronarë me pjesën ideale dhe P.SH Kuvendi i Komunës së Gjakovës  $\frac{1}{2}$  në parcelën me nr. 1190-0 Z. K Gjakovë qytet .
2. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në web faqen e Komunës .
3. Vendimi iu dërgohet:
  - Kryetarit të Komunës së Gjakovës z. Ardian Gjini
  - Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal
  - Drejtorisë për Kadastër Gjeodezi dhe Pronë
  - Shërbimit profesional të Kuvendit të Komunës
  - Arkivit



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Z. Anton Shala